



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

Peshkopi, më .03.2019

RELACION TEKNIK

LËNDA: Mbi punimet që do të kryhen për mirëmbajtjen, riparimin, pastrimin etj.. të kanaleve ujitëse të Bashkisë Dibër.

Nga ana e specialisteve të ujitjes dhe kullimit janë hartuar preventivat për disa kanale ujitëse në territorin e njësisve administrative për vënien në gadishmëri të tyre në mënyrë që procesi I ujitjes të mos ketë probleme.

Kanali ujitës Setë-Fushë-Alije-Kandër ka një gjatësi prej 17 km dhe ujit një sipërfaqe prej 500 ha.

Për shkak të gjatësisë së madhe që ka si kanal ka probleme të shumta. Ka patur dëmtime për gjatë gjatësisë së tij dhe vecanerisht në dy kilometershin e pare, tek vepra e marrjes.

Ka patur rreshqitje te dherave duke e mbushur kanalin dhe duke rrezikuar dhe rreshqitje,dhe për vënien negatishmeri te tij jane planifikuar pastrime përgjatë gjatësisë së kanalit, vepres së marrjes dhe mbulimi me pllaka I pjeses së demtuar.,punime te cilat jane paraqitur ne preventivin perkates.

Në kanalin Setë Dardhë Sinë është parashikuar të bëhet pastrami I tij ne pjeset e shembura te skarpates se kanalit dhe te behen sovatime pjesore ne lagjen Ndreke ku kanali ka rrjedhje .

Kanali ujitës Gramë-Shodoll, ka një gjatësi prej 11.5 km dhe vadit një sipërfaqe prej 550 ha. Ky kanal vadites është dëmtuar si rezultat I rrëshqitjes së terrenit për shkak të shirave të rënë. Për vënien në punë të kësaj vepre është parashikuar ndertimi I murit mbajtes te kanalit ,sheshimi I trasese se kanalit dhe ndertimi I kanalit te ri .Eshte planifikuar ndertimi I nje segmenti rreth 50 metra I cili eshte I demtuar dhe problematik.Keto punime jepen me detaje dhe ne skicat e hartuara .

Kanali Muhurr Brezhdan është degëzim I kanalit Muhurr Brezhdan, ka një gjatësi prej 1 km dhe vadit një sipërfaqe prej 40 ha.

Ky kanal është demtuar ,duke patur rrjedhje (filtrime) uji dhe ka nevojë për venien nepune duke bërë veshjen me beton si dhe pastrimi nga shembja e dherave të rene në kanal si rezultat I rreshqitjeve nga reshjeve .

Kanali Llixha Brezhdan,vija e madhe dhe varendit Dohoshisht do të bëhet heqja dhe zëvendësimi I tubacionit tek perroi I ushtelenxes, pasi ky tubacion është demtuar duke e bërë jofunksional degezimin e kanalit ujites llixha –tomin –kander.

Do të bëhet veshje me beton në kanal dhe somalices një segment I demtuar I cili ka filtrime uji, dhe punime rikonstruksioni në kanal dhe llixhave në degezimin që futet nëpër fshatin Brezhdan,në një gjatësi rreth 500 meter.

Është planifikuar të kryhen punime me skavator për devijimin e ujit tek vepra e marrjes së kanalit të dohoshishtit e cila demtohet si rezultat I reshjeve dhe prurjeve në këtë perrua. Me hollësisht jepen me zërat e punimeve në preventive dhe në skicat përkatëse.

Kanali Trene Selane fshati Pjece ka një gjatësi prej 4 km dhe ujit një sipërfaqe prej 25 ha.

Si rezultat I rrëshqitjes së tokës është demtuar kanali në një gjatësi rreth 38 ml, dhe riparimi I saj do të bëhet duke prishur pjesën e demtuar dhe veshjen me beton të kanalit të kjo pjesë e demtuar.

Për rritjen e efikasitetit të rezervuarit kuplane janë hartuar punime pastrimi dhe veshje me beton të kanalit degezimi që shkon për Bugjunec dhe degezimi për Trene .Jane planifikuar punime pastrimi në kanal dhe ushqyes të liqenit të melanit dhe Trences.Punimet e mesiperme janë të detajuara në preventive dhe me skicat përkatëse.

Kanali ujites Zall Kalis Lugje ka një gjatësi prej 5.5 km dhe ujit një sipërfaqe prej 210 ha.

Në këtë vepër do të kryhen punime në veprën e marrjes (në përroin e Veleshices) sipas preventivit.

Kanali ujites Cernjeve Shumbat ka një gjatësi prej 22 km dhe ka pas ujitur një sipërfaqe prej 400 ha. Ky kanal është demtuar si rezultat I rrëshqitjes së tokës në rrugën Peshkopi-Kukës, rrugë e cila ndodhet 30ml sipër këtij kanali duke e e

demtuar kete kanal ne nje gjatesi rreh 25 m/l, riparimi I se ciles pervec pastrimit I nevojiten dhe tuba ne nje gjatesi rreh 12 m/l (HDPE Ø600) në pjesët e paqëndrueshme të këtij kanali, në mënyrë qe ky kanal të jetë funksional.

Do te behet edhe veshje kanali ne fshatin shumbat lagjia hurdhe ne nje segment rreth 700 metra ku kanali ka filtrime dhe toka rreshqet si pasoje e filtrimeve,punime te cilat paraqiten ne preventive dhe me skicat perkatese.

Kanali ujitës Gurra Sllatinë ka një gjatësi prej 1 km dhe ujit një sipërfaqe prej 30 ha. Do të kryhen punimet e parashikuara sipas preventivit për eliminimin e rrjedhjes ujit ne veprën e quajtur Gurra Sllatine që ndodhet sipër fshatit Sllatine.

Në këtë vepër do te vendosen struktura hekuri (zgarë hekuri Ø 10mm dhe Ø 12mm) në faqet anësore dhe dysHEME në një largësi çdo 12 cm dhe me pas të bëhet betonimi I tyre .

Për kanalet ujitëse në Njësinë Administrative Maqëllare janë parashikuar vënia në punë e veprës ekzistuese (Kanalit ujitës, Rezervuari Maqëllare) tek ai I fshatit Maqëllarë, duke vendosur një nje saracineske Ø200 dhe betonime te kanalit nga saracineska tek tubacioni I hekurit ne nje gjatesi rreth 120 metra.

Gjithashtu është parashikuar (rikonstruksion pjesor) veshje me beton të kanalit ujitës të fshatit Kercisht I eperm dhe Kercisht I poshtem I cili vadit nje siperfaqe rreth 32 hektare.

Do te behet venia ne pune e Rezervuarit Vojnike duke kryer punimet e parashikuara ne kete preventive.

Kanali ujitës Selishte ka një gjatësi prej 6 km. Për vënien në punë të këtij kanali jane parshikuar veshje me beton, mure mbajtes ne pjeset e demtuara te tij si rezultat I rrjedhjes dhe rreshqitjes se tokes

Kanali ujitës Luzni ka një gjatësi prej 5.5 km dhe ujit një sipërfaqe prej 22 ha. Në këtë kanal është parashikuar punime per devijimin e ujit per ne vepren e marrjes pasi si rezultat I prurjeve te dimrit uji ka devijuar nga shtrati per tek vepra e marrjes.

Ing. Fatos Mandrri

Ing. Ornela Roshi